

# Konfliktet

Në rastet e konflikteve mes partnerëve apo në familje, ndihmojnë qendra të ndryshme këshilluese. Dhuna në familje ose mes bashkëshortëve është e ndaluar.

## Konfliktet në marrdhëniet e partnerëve

Nëse në marrdhëniet e partnerëve lindin konflikte, partnerët mund të kërkojnë ndihmë profesionale (këshilla për çiftet, Eheberatung). Qendra të specializuara për këshilla i ndihmojnë ata të gjejnë zgjidhje. Bisedat e para zakonisht janë falas ose me çmime të ulëta. Në çdo rajon ka një qendër këshilluese e cila është përgjegjëse për këtë.

## Konfliktet në familje

Në familjet me fëmijë, mund të ndodhin situata të vështira që mund të jenë të ngarkueshme për prindërit dhe fëmijët. Në çdo rast, është e rekomandueshme që prindërit të kërkojnë ndihmë nëse nuk dinë çfarë të bëjnë më tutje. Në qendrat e këshillimit për familjet (Familienberatungsstelle), mund të kërkohen këshilla personale. Në "Elternnotruf" ekspertët i këshillojnë prindërit përmes telefonit ose postës elektronike rreth edukimit dhe shqetësimeve për fëmijët e tyre (Telefoni 0848 35 45 55 (falas, [www.elternnotruf.ch](http://www.elternnotruf.ch))). Fëmijët dhe të rinjtë mund të kërkojnë ndihmë në "Kindernotruf" përmes telefonit, postës elektronike, SMS ose bisedës (Telefoni 147 (falas), [www.147.ch](http://www.147.ch)).

## Dhuna në shtëpi

Dhuna në familje është vepër penale. Kushdo që përdor dhunë bënë vepër penale - pavarësisht nga pesha e dhunës. Nuk ka rëndësi nëse dhuna drejtohet ndaj bashkëshortit apo ndaj fëmijëve. Autoritetet duhet të ndërmarrin veprime me iniciativën e tyre kur mësojnë për dhunën në familje. Për viktimat e dhunës ka shërbime mbështetëse falas dhe të besueshme. Gratë ose burrat mund të kërkojnë mbrojtje të përkohshme bashkë me fëmijët e tyre në ambiente të posaçme për strehim (Frauenhaus / Väterhaus). Gratë e prekura nga dhuna mund të telefonojnë në Shtëpinë e Grave gjatë gjithë kohës (telefon 062 823 86 00). Fëmijët dhe të rinjtë mund të kontaktojnë përmes linjës telefonike të urgjencës për fëmijë (telefon 147 (falas), [www.147.ch](http://www.147.ch)). Kushdo që ndihet i kërcënuar nga një pjesëtar i familjes duhet të telefonojë në polici (telefon 117). Kjo mund të çojë në largimin e personit që përdor dhunë ose kërcënon nga banesa ose shtëpia për një periudhë më të gjatë kohore.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hola-aargau.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/konfliktet](http://www.hola-aargau.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/konfliktet)